



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____prot.,

Tiranë, më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 24, datë 03.11.2025

PËR

**MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: RREGULLORE “MBI
MASAT ORGANIZATIVE DHE TEKNIKE PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË
RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 03 nëntor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”*

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 56 dhe pika 10 e nenit 157 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për miratim për Këshillim Publik, rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i projektvendimit;

V Ë R E N:

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave mbrojtëse teknike dhe organizative që ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, duhet të ndërmarrin për të garantuar sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve të tyre, parandalimin e incidenteve të sigurisë, si dhe raportimin e tyre pranë AKEP. Rregullorja përcakton detyrimet për operatorët, mënyrën e raportimit të incidenteve, kriteret e vlerësimit të impaktit, si dhe masat organizative dhe teknike që duhet të zbatohen për mbrojtjen kibernetike.
2. Në kuadër të zhvillimeve të vrullshme teknologjike dhe rritjes së kërcënimeve kibernetike ndaj rrjeteve të komunikimeve elektronike, është bërë e domosdoshme përditësimi i kuadrit rregullator në fushën e sigurisë kibernetike. Ligji nr. 54/2024 i ka ngarkuar AKEP me detyrimin për të përcaktuar rregulla të detajuara mbi masat që operatorët duhet të marrin për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të tyre. Kjo rregullore synon të krijojë një standard të unifikuar për të gjithë operatorët, në përputhje me praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar mbrojtjen e përdoruesve dhe funksionimin e qëndrueshëm të rrjeteve kombëtare.
3. Projektakti hartohet në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 54/2024, konkretisht:
 - a. Nenit 56, pika 1, që ngarkon AKEP, me mbikqyrjen e zbatimit të nenit 54, lidhur me marrjen e masave mbrojtëse teknike dhe organizative nga ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, me qëllim garantimin e sigurisë dhe integritetin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike;
 - b. Nenit 157, pika 10, që parashikon detyrimin e autoritetit për të përcaktuar standarde dhe procedura për njoftimin, raportimin dhe trajtimin e incidenteve që ndikojnë në funksionimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike.
3. Projektakti parashikon masa të detajuara në dy nivele:
 - a. Masat organizative – politika të brendshme sigurie, menaxhimi i rrezikut, trajnimi i stafit, vazhdimësia e shërbimit dhe auditimet;
 - b. Masat teknike dhe operacionale – kontrolli i aksesit, enkriptimi, mbrojtja ndaj sulmeve DDoS, fortifikimi i pajisjeve, segmentimi i rrjetit, zbulimi dhe parandalimi i incidenteve.

Këto masa janë të detyrueshme për të gjithë operatorët e autorizuar dhe kanë për qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rikuperimin nga incidentet e sigurisë

4. Dokumenti për këshillim publik: “Rregullore mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” është një dokument i rëndësishëm rregullator i përgatitur në kuadër të hartimit nga AKEP të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 54/2024;
5. Nga pikëpamja e ligjshmërisë është në përputhje me përcaktimet ligjore të pikës 1 të nenit 56, pikës 10 të nenit 157 të ligjit nr. 54/2024;

Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe rregulloren “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit, rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka